



**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[ Data : 06.11.2015]

Për: Operatorin ekonomik “Taulant” shpk me NIPT K61617040L

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për Propozime” me objekt : “Mbikqyrje punimesh i ndarë në pesë lote”, loti me objekt: “Mbikqyrje punimesh për sistemimin anesor te Perroit te Madh, Qender Voskop”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Mbikqyrje punimesh për sistemimin anesor te Perroit te Madh, Qender Voskop”.

Kohëzgjatja: 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Fondi limit: 305.290 (treqind e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Date 09.10.2015.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh: NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH
1	TOWER	180,000
2	ZENIT - 06	225,000
3	TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING	262,550
4	TAULANT	269,727
5	VLER INVEST	269,800
6	STUDIO ARCHIMED	274,761
7	M.A.K Studio	NUK KA OFERTE

Jane skualifikuar ofertuesit e mëposhtem me arsytet perkatëse:

“Tower” shpk per arsye se:

Shoqeria “Tower” shpk nuk ploteson piken 1.3.2 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim pasi ing ndertimi Feti Gjici, ing elektrik Gjergji Kulla dhe ing. Gjeodet Sinan Koce nuk jane te regjistruar ne muajin mars.

“Zenit 06” shpk per arsye se:

Nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem ose kerkesen ku citohet:

“Operatori Ekonomik duhet te kete të përfshirë në ekipin e tij minimalisht:

- Inxhinier topograf minimumi 1(një), me përvojë pune jo më pak se 7 (shtatë) vjet
- Inxhinier elektrik minimumi 1(një), me përvojë pune jo me pak se 7 (shtatë) vjet
- Inxhinier hidroteknik minimumi 1(një), me përvojë pune jo me pak se 7 (shtatë)

vjet

Per secilin inxhinier te paraqiten diplomat, licensat profesionale, CV dhe kontratat e punes.

Inxhinieret e mesiperm duhet te jene pjese e stafit te shoqerise dhe te figurojne ne listepagesat e saj per periudhen Shkurt 2015 deri Gusht 2015”.

Nuk ploteson kete kerkese te Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit pasi per ing. Hidroteknik Leonora Pacili nuk ka paraqitur diplomen. Gjithashtu ing. Leonora Pacili nuk figuron ne listepagesen e kompanise, ndonese kontrata e punes eshte lidhur ne vitin 2012 me afat 10 vjecar.

Nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me numrin e te punesuarve ose kerkesen ku citohet: “Numri i te punesuarve per cdo muaj per periudhen Shkurt 2015 deri Gusht 2015 te mos jete me i vogel se 4 persona. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti duhet te paraqitet nje vertetim nga Administrata Tatimore dhe listepagesat per cdo muaj”. Shoqeria ka paraqitur oferte per te pese lotet. Bazuar ne shenimin ne fund te kerkesave per kualifikim ku citohet: “Nese Operatori Ekonomik paraqit oferte ne me shume se nje lot, per kerkesat 2.2.2, 2.2.3, 2.3.3 dhe 2.3.4 ai duhet

te plotesoje shumatoret e kushteve te secilit lot” ajo duhet te kishte paraqitur dokumentacion me te cilin te vertetonte se numri i te punesuarve per cdo muaj per periudhen Shkurt 2015 deri Gusht 2015 nuk eshte me i vogel se 22 persona, pasi per lotin e pare jane kerkuar 2 persona, per lotin e dyte 3 persona, per lotin e trete 4 persona, per lotin e katert 5 persona dhe per lotin e peste 8 persona; ne total per te pese lotet 22 persona. Shoqeria ka paraqitur dokumentacion se ka 6 persona per muajin janar 2015, 5 persona per muajin shkurt, 8 per muajin mars, 9 per muajin prill, 9 per muajin maj, 9 per muajin qershor, 9 per muajin korrik dhe 8 per muajin gusht, duke mos e plotesuar kushtin.

“Transport Highway Consulting” shpk “Erald - G” shpk dhe “Ecualla” shpk per arsye se:

Bashkimi i perkohshem i shoqerive eshte krijuar bazuar ne Kontraten e Bashkepunimit nr. 9180 Rep dhe 1912 Kol, te dates 08.10.2015, sipas se ciles shoqeria “Transport Highway Consulting” shpk do te kryeje 50% te sherbimeve, shoqeria “Erald G” shpk do te kryeje 30 % te sherbimeve ndersa shoqeria “Ecualla” shpk do te kryeje 20% te sherbimeve. Ne kontrate nuk jane parashikuar sherbimet konkrete qe do te kryeje secila shoqeri dhe, ne kete menyre, komisioni e ka te pamundur te gjykoje per plotesimin e kerkesave per kualifikim. Komisioni vlereson se, ne menyren se si eshte paraqitur kontrata, te treja shoqerite do te kryejne cdo proces te mbikqyrjes sipas ndarjes se parashikuar ne kontrate ne perqindje. Mbi kete baze komisioni konstatoi:

Shoqeria “Transport Highway Consulting” shpk nuk disponon pikat e licenses N.P – 11. “Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë”, N.P – 12. “Punime të inxhinierisë së mjedisit” dhe N.S – 18. “Punime topogjeodezike”. Ne kete menyre ajo nuk mund te kryeje punime mbikqyrje per keto pika.

Shoqeria “Transport Highway Consulting” shpk nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem ose kerkesen ku citohet:

“Operatori Ekonomik duhet te kete të përfshirë në ekipin e tij minimalisht:

- Inxhinier topograf minimumi 1(një), me përvojë pune jo më pak se 7 (shtatë) vjet
- Inxhinier elektrik minimumi 1(një), me përvojë pune jo me pak se 7(shtatë) vjet
- Inxhinier hidroteknik minimumi 1(një), me përvojë pune jo me pak se 7 (shtatë)

Vjet.

Per secilin inxhinier te paraqiten diplomat, licensat profesionale, CV dhe kontratat e punes.

Inxhinieret e mesiperm duhet te jene pjese e stafit te shoqerise dhe te figurojne ne listepagesat e saj per periudhen Shkurt 2015 deri Gusht 2015”. Nuk ploteson kete kerkese te Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion se ka te punesuar Inxhinier topograf, elektrik dhe hidroteknik.

Shoqeria “Erald - G” shpk nuk ploteson kerkesen e vecante te kualifikimit lidhur me aktivitetin e qendrushem ne tre vitet e fundit, pasi nuk ka paraqitur bilancet ne perputhje me kerkesen.

Shoqeria “Erald - G” shpk nuk ploteson kerkesen e vecante te kualifikimit lidhur me xhiron e realizuar ne tre vitet e fundit, pasi nuk ka paraqitur vërtetim te leshuar nga dega e Tatim Taksave ku ushtron aktivitetin Operatori Ekonomik mbi xhiron vjetore të shoqërisë per tre vitet e fundit.

Shoqeria “Ecualla” shpk nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem ose kerkesen ku citohet:

“Operatori Ekonomik duhet te kete të përfshirë në ekipin e tij minimalisht:

- Inxhinier topograf minimumi 1(një), me përvojë pune jo më pak se 7 (shtatë) vjet
- Inxhinier elektrik minimumi 1(një), me përvojë pune jo me pak se 7 (shtatë) vjet
- Inxhinier hidroteknik minimumi 1(një), me përvojë pune jo me pak se 7 (shtatë)

vjet

Per secilin inxhinier te paraqiten diplomat, licensat profesionale, CV dhe kontratat e punes.

Inxhinieret e mesiperm duhet te jene pjese e stafit te shoqerise dhe te figurojne ne listepagesat e saj per periudhen Shkurt 2015 deri Gusht 2015". Nuk ploteson kete kerkese te Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion se ka te punesuar Inxhinier topograf dhe elektrik.

Shoqeria "Ecualla" shpk nuk disponon pikat e licenses N.P – 11. "Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë", N.P – 12. "Punime të inxhinierisë së mjedisit" dhe N.S – 18. "Punime topogjeodezike". Ne kete menyre ajo nuk mund te kryeje punime mbikqyrje per keto pika.

"Vler Invest" shpk dhe "Infratech" shpk per arsye se:

Shoqeria "Vler Invest" shpk nuk ploteson kerkesen e pergjithshme per kualifikim lidhur me pagesen e tatimeve dhe sigurimeve shoqerore, pasi nuk ka paraqitur vertetimin e kerkuar leshuar nga administrata tatimore.

Shoqeria "Vler Invest" shpk nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem ose kerkesen ku citohet:

"Operatori Ekonomik duhet te kete të përfshirë në ekipin e tij minimalisht:

- Inxhinier topograf minimumi 1(një), me përvojë pune jo më pak se 7 (shtatë) vjet
- Inxhinier elektrik minimumi 1(një), me përvojë pune jo me pak se 7 (shtatë) vjet
- Inxhinier hidroteknik minimumi 1(një), me përvojë pune jo me pak se 7 (shtatë)

vjet

Per secilin inxhinier te paraqiten diplomat, licensat profesionale, CV dhe kontratat e punes.

Inxhinieret e mesiperm duhet te jene pjese e stafit te shoqerise dhe te figurojne ne listepagesat e saj per periudhen Shkurt 2015 deri Gusht 2015".

Nuk ploteson kete kerkese te Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit pasi per inxhinierin hidroteknik Bashkim Sali dhe per inxhinierin elektrik Vangjush Lubonja nuk ka paraqitur diplomen.

Shoqeria "Vler Invest" shpk nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me numrin e te punesuarve ose kerkesen ku citohet: "Numri i te punesuarve per cdo muaj per periudhen Shkurt 2015 deri Gusht 2015 te mos jete me i vogel se 4 persona. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti duhet te paraqitet nje vertetim nga Administrata Tatimore dhe listepagesat per cdo muaj". Shoqeria ka paraqitur oferte lotet 1, 3 dhe 4. Bazuar ne shenimin ne fund te kerkesave per kualifikim ku citohet: "Nese Operatori Ekonomik paraqit oferte ne me shume se nje lot, per kerkesat 2.2.2, 2.2.3, 2.3.3 dhe 2.3.4 ai duhet te plotesoje shumatoret e kushteve te secilit lot" si dhe ne perqindjen e sherbimeve qe ka marre persiper (90%) ajo duhet te kishte paraqitur dokumentacion me te cilin te vertetonte se numri i te punesuarve per cdo muaj per periudhen Shkurt 2015 deri Gusht 2015 nuk eshte me i vogel se rreth 10 persona, pasi per lotin e pare jane kerkuar 2 persona, per lotin e trete 4 persona dhe per lotin e katert 5 persona ; ne total per te tre lotet 11 persona dhe sipas perqindjes 0.9 x 11 afersisht 10 persona. Shoqeria ka paraqitur dokumentacion se per janarin, shkurtin dhe marsin ka 7 punonjes, per prillin dhe majin ka 11,

per qershorin ka 10, per korrikun ka 11, per gushtin nuk ka informacion. Ne kete menyre nuk ploteson kete kusht.

Shoqeria "Vler Invest" shpk nuk ploteson kerkesen per realizimin e sherbimeve te ngjashme, pasi per kontratat e paraqitura nuk ka paraqitur faturat tatimore ne perputhje me kerkesen.

Shoqeria "Infratech" shpk nuk ploteson kerkesen per realizimin e sherbimeve te ngjashme, pasi per kontratat e paraqitura nuk ka paraqitur faturat tatimore ne perputhje me kerkesen.

“Studio Archimed” shpk dhe “Klodioda” shpk per arsye se:

Bashkimi i perkohshem i shoqerive eshte krijuar bazuar ne Kontraten e Bashkepunimit nr. 1093 Rep dhe 192 Kol, te dates 08.10.2015, sipas se ciles shoqeria “Studio Archimed” shpk do te kryeje 60% te sherbimeve, ndersa shoqeria “Klodioda” shpk do te kryeje 40 % te sherbimeve. Ne kontrate nuk jane parashikuar sherbimet konkrete qe do te kryeje secila shoqeri dhe, ne kete menyre, komisioni e ka te pamundur te gjykoje per plotesimin e kerkesave per kualifikim. Komisioni vlereson se, ne menyren se si eshte paraqitur kontrata, te dyja shoqerite do te kryejne cdo proces te mbikqyrjes sipas ndarjes se parashikuar ne kontrate ne perqindje. Mbi kete baze komisioni konstatoi:

Shoqeria “Studio Archimed” shpk nuk disponon pikat e licenses N.S – 18. “Punime topogjeodezike”, N.P – 12. “Punime të inxhinierisë së mjedisit” dhe N.P – 5. “Punime nëntoksore, ura e vepra arti”. Ne kete menyre ajo nuk mund te kryeje punime mbikqyrje per keto pika.

Shoqeria “Studio Archimed” shpk nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem ose kerkesen ku citohet:

“Operatori Ekonomik duhet te kete të përfshirë në ekipin e tij minimalisht:

- Inxhinier topograf minimumi 1(një), me përvojë pune jo më pak se 7 (shtatë) vjet
- Inxhinier elektrik minimumi 1(një), me përvojë pune jo me pak se 7 (shtatë) vjet
- Inxhinier hidroteknik minimumi 1(një), me përvojë pune jo me pak se 7 (shtatë)

vjet

Per secilin inxhinier te paraqiten diplomat, licensat profesionale, CV dhe kontratat e punes.

Inxhinieret e mesiperm duhet te jene pjese e stafit te shoqerise dhe te figurojne ne listepagesat e saj per periudhen Shkurt 2015 deri Gusht 2015”. Nuk ploteson kete kerkese te Kerkesave te Vecanta te Kualifikimit pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion se ka te punesuar Inxhinier topograf, inxhinier elektrik dhe inxhinier hidroteknik.

Shoqeria “Studio Archimed” shpk nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me numrin e te punesuarve ose kerkesen ku citohet: “Numri i te punesuarve per cdo muaj per periudhen Shkurt 2015 deri Gusht 2015 te mos jete me i vogel se 4 persona. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti duhet te paraqitet nje vertetim nga Administrata Tatimore dhe listepagesat per cdo muaj”. Shoqeria ka paraqitur oferte lotet 1, 3 dhe 4. Bazuar ne shenimin ne fund te kerkesave per kualifikim ku citohet: “Nese Operatori Ekonomik paraqit oferte ne me shume se nje lot, per kerkesat 2.2.2, 2.2.3, 2.3.3 dhe 2.3.4 ai duhet te plotesoje shumatorete e kushteve te secilit lot” si dhe ne perqindjen e sherbimeve qe ka marre persiper (60%) ajo duhet te kishte paraqitur dokumentacion me te cilin te vertetonte se numri i te punesuarve per cdo muaj per periudhen Shkurt 2015 deri Gusht 2015 nuk eshte me i vogel se rreth 13 persona, pasi per lotin e pare jane kerkuar 2 persona, per lotin e dyte 3 persona, per lotin e trete 4 persona, per lotin e katert 5 persona dhe per lotin e peste 8 persona; ne total per te pese lotet 22 persona dhe sipas perqindjes 0.6 x 22 afersisht 13 persona. Shoqeria ka paraqitur dokumentacion se per shkurtrin marsin dhe prillin ka 8 punonjes, per majin 9 punonjes, per qershorin 8 punonjes, per korrikun dhe gushtin 7 punonjes. Ne kete menyre nuk ploteson kete kusht.

Shoqeria “Klodioda” shpk nuk ploteson piken 2.1.d te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim pasi mungon vertetimi per shlyerjen e detyrimeve ndaj OSHEE per muajin Gusht 2015 (detyrim ky i maturuar ne daten 9 Tetor 2015, dita e tenderit).

Te skualifikojte shoqerine “M.A.K. Studio” shpk per arsye se nuk ka paraqitur oferte.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “Taulant” shpk, me NIPT K61617040L, se oferta e paraqitur, me vlerë 269.727 (dyqind e gjashtedhjetë e nente mije e shtateqind e njezet e shtate) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor:

- Fondi Shqiptar i Zhvillimit
- Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania
- Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)
- Fax: 00355 4 2 234 885

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 27.10.2015.

Ankesa: Nuk ka patur.

